



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Psh. nr. 125/22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, nenin 118 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, nenin 10 par 10.1 i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimi të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Odiseja”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës” me numër të prokurimit 611-22-3360-2-2-1, iniciuar nga AK- KK Drenas, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 27. 05. 2022, mori këtë:

VENDIM

- I. **Hedhet si jo e plotë**, ankesa e OE “Odiseja”, me nr. të protokollit 125/22 e datës 05 maj 2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës” me numër të prokurimit 611-22-3360-2-2-1, iniciuar nga AK- KK Drenas.
- II. **I LEJOHET**, autoritetit kontraktues – KK Drenas, që të vazhdoj më tutje me

procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës” me numër të prokurimit 611-22-3360-2-2-1, iniciuar nga AK-KK Drenas.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “Odiseja”, me datën 22. 04. 2022, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në autoritetin kontraktues kundër vendimit të AK-së. Autoriteti kontraktues me datën 26. 04. 2022 ka refuzuar vendimin e operatorit ekonomik ankues.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në sistemin elektronik me datë 05 maj 2022, ka pranuar ankesë nga OE “Odiseja”, për aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve për nevojat e Komunës” me numër të prokurimit 611-22-3360-2-2-1, iniciuar nga AK- KK Drenas.

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas analizimit të lëndës, sqaron se ankesa e operatorit ekonomik ankues është jo e plotë për faktin se OE ankues nuk ka paguar tarifën konform nenit 118 të LPP-së.

Operatori ekonomik ka dorëzuar në OSHP dëshminë se ka paguar tarifën, mirëpo nga thesari është konfirmuar se mjetet nuk kanë kaluar në xhirollogarinë e OSHP-së. OSHP ka kontaktuar me Bankën Procredit ku është kryer pagesa, dhe të njëjtit me datën 20 maj 2022 kanë deklaruar: “Ju lutem jeni të informuar se dokumenti është origjinal, kurse pagesa është kthyer mbrapa meqë UNIREF-i ka qenë gabim”. OSHP, ka kontaktuar me email me operatorin ekonomik i cili ka deklaruar se janë në pushim dhe kur kthehen me 26 maj 2022 do të merren me këtë çështje, por në xhirollogarinë e OSHP-së nuk kanë arritur mjetet me datën 26 maj 2022 ashtu sic operatori ekonomik ka deklaruar.

Me datën 27 maj 2022 nga zyrtarja e të hyrave është kontaktuar operatori ekonomik përmes telefonit dhe të njëjtit kanë deklaruar se akoma nuk e kanë paguar por “do ta paguajnë brenda 10 minutave” dhe do ta konfirmojnë pagesën e tarifës.

OSHP ka pritur që gjatë tërë ditës që OE ta paguajë tarifën ashtu siç ka thënë edhe pse ka tejkaluar afatin, mirëpo pagesa nuk është konfirmuar se është bërë nga ta, andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit, konsideron se ankesa është jo e plotë dhe nuk është konform nenit 118 të LPP-së ku thuhet:

1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin dytësor. Dëshmia e pagesës duhet ti bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare.
2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet.

Duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë, OSHP konstaton se ankesa e parashtruar nga OE ankues, është e pakompletuar andaj edhe e njëjta nuk mund të shqyrtohet.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK – KK Drenas
- 1x1 OE-“ Odiseja” me seli në Prishtinë
- 1x1 Arhivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së